



REPUBLIKA E KOSOVËS/REPUBLIKA KOSOVA

GJYKATA THEMELORE FERIZAJ

---

Numri i lëndës: 2018:015037

Datë: 28.04.2023

Numri i dokumentit: 04234565

**P.nr.999/14**

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ, DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**, gjyqtari i vetëm gjykues Imri Sejda, me zyrtaren ligjore Kimete Bytyqi, në çështjen penale kundër të pandehurit B.S., për shkak të veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 të Kodit përkohshëm penal të Kosovës ( KPPK-së ), duke vendosur sipas aktakuzës së Prokurorisë Themelore Ferizaj PP/II.nr.2536-6/13, të dt.08.09.2014, konform nenit 90 par 1 pika 1.4, nenit 91 par. 6 të KPPK-së dhe nenit 248 par.1 nën par. 1.3 të KPPRK-së, me dt.28.4.2023 mori këtë:

### **A K T V E N D I M**

**Hudhët aktakuza** e Prokurorisë Themelore në Ferizaj, PP/II.nr.2536-6/13, të dt.08.09.2014, ndaj të pandehurit B.S., nga i ati H., e ëma N., i lindur më dt....., në Ferizaj, ku dhe tani jeton rr. “...” për shkak të kryerjes së veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 253 par.1 të Kodit përkohshëm penal të Kosovës ( KPPK-së) dhe pushohet procedura penale për shkak të **parashkrimit absolut** të ndjekjes penale.

Shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

### **A r s y e t i m i**

Prokuroria Themelore në Ferizaj, me aktakuzën PP/II.nr.2536-6/13, të dt.08.07.2014, ka ngarkuar të pandehurin për shkak të kryerjes së veprës penale Vjedhje e rëndë nga neni 253

par.1 të Kodit përkohshëm penal të Kosovës ( KPPK-së ) dhe ka kërkuar që i pandehuri të shpallet fajtor dhe të dënohet sipas ligjit.

Nga dispozitivi i aktakuzës rezulton se vepra penale është kryer më datë 25.12.2012 dhe për këtë veprë penale sipas nenit 253 par.1 të KPPK-së, është paraparë dënim me burgim deri në 5 (pesë ) vite.

Në nenin 90 par.1 pikë 4 të KPPK-së, parashihet se ndjekja penale për vepra penale të dënueshme deri 5 ( pesë) vite burgim, nuk mund të ndërmerret nëse ka kaluar afati prej 5 /pesë/ viteve nga data e kryerjes së veprës penale-parashkrimi relativ, e në rastin konkret janë ndërmarr disa veprime me të cilat është ndërpre parashkrimi relativ, mirëpo deri më datën e nxjerrjes së këtij aktvendimi tani kanë kaluar mbi 10 (dhjetë) vite dhe për këtë ka arritur parashkrimi absolut dhe rrjedhimisht ndjekja penale më nuk mund të ndërmerret për shkak se ka ndodhur parashkrimi absolut i kësaj vepre penale.

Në nenit 91 pika. 6 të KPPK-së, thuhet se ndjekja penale ndalohet në çdo rast kur të ketë kaluar dyfishi i kohës së afatit të parashkrimit (parashkrimi absolut i ndjekjes penale) e që në rastin konkret nga data e kryerjes së veprës penale që është data 25.12.2012, kanë kaluar më tepër se 10 (dhjetë) vite, e që nënkupton se në këtë çështje penale ka ndodhur parashkrimi absolut dhe më nuk mund të bëhet ndjekja penale.

Konform nenit 453 par.1 të KPPRK –së, shpenzimet e procedurës penale bien në barrë të mjeteve buxhetore.

Nga arsyet e lartcekura, u vendos si në dispozitiv të këtij aktvendimi.

**GJYKATA THEMELORE NË FERIZAJ**  
**DEPARTAMENTI I PËRGJITHSHËM – DIVIZIONI PENAL**  
**P.nr. 999/14, me datë 28.04.2023**

Zyrtare ligjore  
Kimete Bytyqi

Gjyqtari:  
Imri Sejda

**KËSHILLA JURIDIKE:** kundër këtij aktvendimi është e lejuar ankesa Gjykatës së Apelit në Prishtinë në afat prej 3 /tri/ ditëve nga dita e pranimit të kopjes me shkrim të këtij aktvendimi, përmes kësaj gjykate.